

V E N D I M
Nr. 535, datë 31.10.2002

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AGJENCISË SË NXITJES SË INVESTIMEVE TË
HUAJA (ANIH) PËR VITIN 2002**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 8 të ligjit nr. 8877, datë 4.4.2002 "Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja, për periudhën e mbetur të vitit 2002, t'i jepet fondi prej 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekësh për përballimin e shpenzimeve operative të kësaj agjencie, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKS

**PASQYRA PËRMBLEDHËSE E BUXHETIT TË AGJENCISË SË NXITJES
SË INVESTIMEVE TË HUAJA**

(000 lek)

		SHUMA
Zërat e shpenzimeve		
Shpenzime për paga e shpërblime		2500
Pagat e punonjësve	17*53*2 muaj)	1810
Pagesa e sigurimeve shoqërore	(34%*1802)	600
Fondi i veçantë	(5%*1802)	90
Shpenzime operative		1500
Shpenzime marketingu/promocioni		
Shpërblimi i Këshillit mbikëqyrës		627
Kryetari	(30%*110*3 mbledhje	66
Anëtarët	(20%*110*3 mbledhje*10 persona)	350
Tel/fax	(100.*2 muaj)	100
Internet	(14*2muaj)	28
Energji elektrike	(28*2 muaj)	56
Karburant	(42*2muaj)	50
Kancelari	(40* 2 muaj)	40
Shpenzime postare	(7*2 muaj)	14
Roje objekti	(20*3*1,3*2 muaj)	156
Mirëmbajtje ambienti	(15*2 muaj)	30
Shpenzime për udhëtime e dieta (brenda e jashtë shtetit)		400
Shpenzime për riparim automjeti	(13* 2 muaj)	0
Shpenzime për pritje, përcjellje	(30* 2 muaj)	60
Shpenzime për investime		2500
Rezervë		0
Totali		6500